




**INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË
PUBLIKE TË KOSOVËS**



**SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCË, COVID-19 DHE
PATOGENËT TJERË RESPIRATORË NË KOSOVË,
SEZONA 2025/2026 (JAVA 01-RË)**

Simptomet e Gripit përfshijnë:

- Temperaturë/ethe
- Kokëdhimbje
- Lodhje
- Kollë e thatë
- Dhimbje fyti
- Rrjedhje hundësh
- Dhimbje muskulare
- Simptome gastrointestinale, si nauze dhe barkqitje




PËRMBLEDHJE

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike gjatë tërë vitit bën mbikëqyrjen permanente të Influençës sezonale (ILI), ARI dhe SARI me intensifikim të aktiviteteve gjatë sezonës përkatëse. Mbikëqyrja realizohet përmes hulumtimit aktiv dhe pasiv në institucione shëndetësore dhe terren.

SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCËN SEZONALE NË KOSOVË, 2021/2022 - 2025/2026

Sipas grafikoni 1, ku janë paraqitur rastet e Influencës sezonale (ILI) në 5 sezonat e fundit shohim se sezona 2025/2026 karakterizohet me numër më të ulët të rasteve të raportura, krahasuar me periudhën e njëjtë të sezonës 2024/2025 dhe fillim të aktivitetit nga java e 40-të e sezonës 2025/2026.

Grafikoni.1



SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCËN SEZONALE NË KOSOVË, 2025/2026 DHE PRAGU EPIDEMIK


Nga fillimi i sezonës, 29 shtator 2025 deri më 04 janar 2026 (java e 01-rë) në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës janë raportuar 28,642 raste të Sëmundjes të ngjashme me Grip (ILI), 4,814 raste të Infeksioneve respiratore akute (ARI) dhe 37 raste me Infeksion të rëndë respirator akut (SARI).

Gjatë javës së 01-rë (29.12.2025-04.01.2026) janë raportuar 3,519 raste ILI (Sëmundje e Ngjashme me Gripin), 400 raste ARI (Infeksion Respirator Akut) dhe 2 raste SARI (Infeksion i Rëndë Akut Respirator).

Përmes sistemit të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse dhe paralajmërimit të hershëm (SMSN) janë raportuar 724 raste ILI, 10 raste ARI dhe 2 SARI.


Intensiteti i Influencës sezonale sipas numrit të rasteve të raportuara për javën e 01-rë paraqitet në aktivitetin e lartë të qarkullimit por krahasuar me javën e kaluar shënon rënie prej 12.7%. (Graf.2)


Grafikoni.2



Në grafikoni 3 shohim se në të gjitha komunat janë raportuar raste të dyshimta në Influencë dhe sipas numrit të rasteve të raportuara, numër më të lartë kanë komuna e Prishtinës, Mitrovicës, Pejë dhe Prizrenit ndërsa sipas Incidencës numër më të lartë të rasteve kanë komuna e Kamenicës dhe Mitrovicës.


Grafikoni.3





Në raport me distribuimin e rasteve sipas grup-moshës dhe incidencës, nga numri total i rasteve të raportuara me ILI, shihet se të gjitha grup-moshat janë të atakuara derisa sipas Incidencës; grup-mosha 0-4 dhe mbi 65 vjeç. Sa i përket rasteve me ARI, grup-mosha më e atakuar është 0-4 vjeç (3,456 raste) pastaj grup-mosha 5-14 vjeç (642 raste), 15-64 vjeç (478 raste), dhe grup-mosha 65+ vjeç (238 raste). (Graf.4)

Grafikoni.4




MBIKËQYRJA VIROLOGJIKE

Në laboratorin e Qendrës Kombëtare të Influcencës – IKSHPK nga fillimi i sezonës 2025/2026 deri më 7 janar 2026, janë testuar gjithsej 2,583 mostra nga pacientët e qendrave sentinel dhe jo sentinel si raste të dyshimta në ILI, ARI dhe SARI. Nga mostrat e testuara 1,294 (50.1%) prej tyre të dyshimta në SARS-CoV-2 dhe 1.289 (49.9%) të dyshimta në Influcencë dhe patogjenët tjerë respiratorë. Gjatë kësaj periudhe në SARS-CoV-2 janë konfirmuar 20 raste (1.5%). Nga 1,289 mostrat e testuara në Influcencë dhe patogjenët tjerë respiratorë janë konfirmuar 269 raste me Influcencë A (pozitiviteti 20.9%). Rastet e konfirmuara me Influcencë A janë nga komuna e Prishtinës (107 raste), Mitrovicë (55 raste), Fushë Kosovë (15 raste), Malishevë (11 raste), Ferizaj (10 raste), Podujevë (10 raste), Vushtrri (9 raste), Lipjan (8 raste), Drenas (7 raste), Skenderaj (5 raste), Kaçanik (5 raste), Gjakovë (4 raste), Gjilan (4 raste), Pejë (3 raste), Suharekë (3 raste), Viti (3 raste), Klinë (2 raste), Rahovec (2 raste), Graçanicë (2 raste) dhe me nga 1 rast komunat : Kamenicë Novobërdë, Obiliq dhe Prizren, dhe i takojnë grup-moshës 0-4 vjeç (124 raste), 5-14 vjeç (70 raste), 15-34 vjeç (31 raste), 35-50 vjeç (12 raste), 51-64 vjeç (9 raste) dhe 65+ (23 raste). Gjatë javës së parë (29.12.2025-04.01.2026), nga laboratorët private janë raportuar gjithsej 21 mostra të testuara si të dyshimta në SARS-CoV-2. Nga këto mostra nuk është konfirmuar asnjë rast pozitiv. Nga patogjenët tjerë respiratorë, janë konfirmuar: 163 mostra me RSV, 232 mostra me Human Rhinovirus, 126 mostra me Human Adenovirus, 27 mostra me Parainfluenza Virus dhe 9 mostra me Metapneumovirus (Graf.5).


Rastet pozitive në RSV (12.6%), janë nga komuna e Prishtinës (74 raste), Fushë Kosovë (24 raste), Ferizaj (12 raste), Podujevë (9 raste), Lipjan (5 raste), Malishevë (4 raste), Obiliq (3 raste), Viti (3 raste), Prizren (3 raste), Gjilan (3 raste), Mitrovicë (3 raste), Rahovec (2 raste), Vushtrri (2 raste), Hani i Elezit (2 raste), Kaçanik (2 raste), Klinë (2 raste), Shtime (2 raste) dhe me nga 1 rast komuna: Deçan, Drenas, Graçanicë, Gjakovë, Istog, Suharekë, Novobërdë dhe Pejë. Rastet pozitive me RSV i takojnë grup-moshës 0-4 vjeç (142 raste), 5-14 (11 raste), 15-34 (4 raste), 35-50 (1 rast) dhe 65+ (5 raste) (Graf.5).

Grafikoni.5



Sipas subtipit: me subtipin AH3 janë konfirmuar 32 raste apo 12%, me subtipin AH1N1 janë konfirmuar 12 raste apo 4% dhe me Influencë A të pa subtipizuar janë konfirmuar 225 raste apo 84%.(Graf.6.)

Grafikoni. 6



AKTIVITETET SEZONALE

IKSHPK/Departamenti i Epidemiologjisë bënë mbikëqyrjen e Influencës gjatë tërë vitit, me intensifikim të saj gjatë sezonës përkatëse (java e 40 deri në javën e 20).

Përcjell situatën epidemiologjike me rastet ILI/ARI (javore) dhe rastet me SARI (në bazë ditore/alerti).

Bënë testimin laboratorik të mostrave në Departamentin e Mikrobiologjisë/Qendrën Kombëtare për Testimin e Influencës.

Ka dhënë këshilla për popullatën për mbrojtjen nga sëmundja dhe njohjen e simptomave të saj.

MASAT PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË VIRUSIT TË GRIPIT SEZONAL

Aktiviteti i gripit për sezonën 2025/2026, është në nivel më të lartë krahasuar me sezonën paraprake dhe masat për parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve respiratore janë:

Mbajtja e maskave.

Distanca fizike.

Higjiena e duarve.

Evitimi i kontakteve të afërta me individë të sëmurë.

Redukimi i vizitave të familjarëve tek personat e hospitalizuar (SHSKUK, Spitalet rajonale).

Evitimi i vendeve të mbyllura dhe të mbingarkuara me njerëz.

Ushqimi i shëndetshëm me shumë vitamina.

Aktiviteti fizik dhe gjumë i mjaftueshëm.

Personat e sëmurë të qëndrojnë në shtëpi.

- Pastrimi dhe dezinfektimi i mjediseve ku qëndroni.
- Mbulimi i hundës dhe gojës me një shami gjatë teshtitjes dhe kollitjes si dhe hudhja më pas në vend të sigurt.
- Larja e duarve shpesh me ujë dhe sapun, ose solucione duarsh me alkool.
- Sytë, hunda dhe goja të mos preket me duar të kontaminuar, pasi virusi përhapet në këtë mënyrë.
- Pastrimi dhe dezinfektimi i sipërfaqeve dhe objekteve që mund të jenë kontaminuar nga virusi.

Konsultimi me mjekun për mjekimin me barna kundër gripit, të cilat duhet të merren vetëm me rekomandimin e mjekut

Medikamentet kundër gripit duhet të fillohen brenda 48 orëve të para të fillimit të sëmundjes për të pasur efektivitet të lartë.

Ato mund të parandalojnë edhe komplikimet e rënda që mund të vijnë nga gripit.

Mënyra më efektive për parandalimin e virusit të gripit është Vaksinimi me vaksinën kundër gripit.

- Vaksinimi mbron vetë personin dhe ndihmon në parandalimin e përhapjes së gripit.
- Efekti i vaksinës fillon 1 deri 2 javë pas marrjes dhe mbrojtja vazhdon rreth një vit pas vaksinimit.

VAKSINIMI

Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me IKSHPK në fillim të sezonës së gripit 2025/2026 ka siguruar 85,000 doza të vaksinës sezonale dhe me fillimin e sezonës ka filluar vaksinimi sipas rekomandimeve. Deri më 18 nëntor janë administruar gjithsej 62,262 doza të vaksinës kundër gripit sezonal. Prej tyre sipas grupeve të rrezikut: 41,703 janë administruar te grup-mosha mbi 65 vjeç, 18,799 me sëmundje kronike, 1,247 profesionistë shëndetësor, 6 gra shtatëzëna, 45 fëmijë (0-5 vjeç), 192 zyrtarë policorë dhe 29 mësimdhënës, të tjerë 241.

HOSPITALIZIMET

Gjatë javës së fundit nga rastet e hospitalizuara në Klinikën Infektive, Klinikën e Pediatriisë dhe spitalet rajonale janë raportuar 64 raste me ARI, 11 raste me ILI dhe 2 raste me SARI.

Nga Klinika Infektive deri më 04 janar 2026, janë raportuar 2 raste të vdekjes me Influcencë A. Një nga rastet është e gjinisë femërore dhe tjetri i gjinisë mashkullore; i përkasin grup-moshës mbi 65 vjeç dhe me sëmundje kronike përcjellëse.

SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE NË RAJON DHE EVROPË**INFLUENCA SEZONALE JAVA 01/2026 NË EVROPË**

Gjatë javës së parë, në shumicën e vendeve raportuese, aktiviteti i infeksioneve respiratore vazhdon të mbetet i lartë dhe mbi nivelet bazë të pritshme për këtë sezon. Në pjesën më të madhe të vendeve, normat e sëmundjes së ngjashme me gripin (ILI) dhe të infeksioneve akute respiratore (ARI) janë mbi pragun bazë, duke treguar rritje të qarkullimit viral në nivel rajonal. Treguesit e aktivitetit të Influcencës vijojnë të shënojnë rritje të mëtejshme, si në intensitet, ashtu edhe në numrin e detektimeve laboratorike dhe në nivelin e pozitivitetit, i cili është më i lartë tek fëmijët e grupmoshës 5–14 vjeç. Njëkohësisht, hospitalizimet për Influcençë po rriten, me barrën më të madhe të sëmundjes të vërejtur tek personat e moshës mbi 65 vjeç. Virusi dominues në qarkullim mbetet Influenca e tipit A(H3), si në mbikëqyrjen sentinel të kujdesit parësor, ashtu edhe në mbikëqyrjen spitalore, duke konfirmuar një sezon të dominuar nga ky nën-tip. Megjithatë, në qarkullim vazhdojnë të identifikohen edhe viruse të Influcencës A(H1)pdm09, por në përqindje më të ulëta. Në të kundërt, aktiviteti rajonal i SARS-CoV-2 vazhdon të jetë në rënie dhe pozitiviteti mbetet i ulët në krahasim me Influcençën, si në mbikëqyrjen sentinel, ashtu edhe në rastet e infeksioneve akute respiratore të rënda (SARI). Qarkullimi i RSV-së po shënon një rritje graduale në nivel rajonal, me përqindjen më të lartë të rasteve tek fëmijët nën moshën 5 vjeç, megjithëse aktualisht aktiviteti i tij mbetet në nivele më të ulëta krahasuar me Influcençën. Të dhënat nga mbikëqyrja e SARI tregojnë rritje të pozitivitetit për Influcençën, ndërsa rritje të hospitalizimeve dhe të shtrimeve në kujdes intensiv janë raportuar vetëm në një numër të kufizuar vendesh. Vdekshmëria nga COVID-19, si dhe vdekshmëria nga të gjitha shkaqet, vazhdojnë të jenë në nivele të pritshme për këtë periudhë, pa sinjale që sugjerojnë tejkalim të normave historike. Karakterizimi virologjik konfirmon vazhdimësinë e dominimit të Influcencës A(H3), me disa klade në qarkullim, si dhe praninë më të kufizuar të viruseve A(H1)pdm09 dhe të Influcencës B/Victoria. Rekomandimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë për përbërjen e vaksinës trivalente për sezonin 2025/2026 pasqyrojnë këtë situatë virologjike. Sa i përket SARS-CoV-2, varianti XFG vazhdon të mbetet linja mbizotëruese e raportuar në Evropë. Në tërësi, panorama epidemiologjike në rajon karakterizohet nga një sezon i theksuar i Influcencës, me ndikim më të madh tek fëmijët dhe të moshuarit, ndërkohë që aktiviteti i SARS-CoV-2 mbetet i ulët dhe i qëndrueshëm, dhe RSV po rritet gradualisht pa arritur nivele alarmante.

Burimi: <https://erviss.org/>